

Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik rural – zonat e pafavorizuara malore (SARED)

Fuqia në treg e thesareve të fshehura: Ferma malore shqiptare

Përgatitja e ekonomisë rurale për tregun evropian

Papunësia dhe të ardhurat e ulëta deri në nivele aktuale të varfërisë janë tipare karakteristike të zonave malore të Shqipërisë. Fermerët kanë luftojnë me vështirësitë për të hyrë në tregje, për të përballuar konkurrencën e fortë dhe kërkesën në rritje për cilësi. Në përgjigje të kësaj situatë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZRAU) ka hartuar një Strategji Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Bujqësor e Rural (ISARD), e cila synon mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës. Qeveria gjermane dhe ajo daneze po mbështesin qeverinë Shqiptare për zbatimin e kësaj strategjie.

Për çfarë bën fjalë programi SARED?

“Nga toka në pjatë” është qasja gjithësore e programit SARED, që zbatohet bashkërisht nga MBZRAU dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), për llogari të qeverisë gjermane dhe që bashkëfinancohet nga qeveria daneze.

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat në qershor të vitit 2014, Shqipëria po bën hapa përpara drejt anëtarësimit në BE. Megjithatë, vendit i duhen reforma të gjera në sektorin publik e privat. Kështu, kërkohen ndryshime thelbësore, sidomos në sektorin bujqësor.

Duke pasur parasysh këtë këndvështrim, është hartuar një Strategji Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (ISARD), që është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Titulli i projektit:	Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik rural në zonat e pafavorizuara malore (SARED)
Porositur nga:	Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)
Bashkëfinancues:	Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës, The Danish Neighbourhood Programme
Rajoni i projektit:	Shqipëria, me përqendrim në zonat malore
Agjencia kryesore zbatuese:	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZRAU)
Kohëzgjatja:	01.06.2014–31.05.2018

Përfitimet


Studime të shumta përshkruajnë burimet pak të shfrytëzuara bujqësore, sidomos në zonat malore të Shqipërisë. Aktualisht, prodhimi i fermerëve është më së shumti i orientuar për nga subvencionet, duke qenë se i mungojnë zinxhirët e mirëstrukturuar të vlerës, që do t’iu jepnin mundësi të hynin në tregje. Me mbështetjen e strategjisë ndërsektoriale për zhvillim (ISARD) dhe aftësinë e fermerëve për të përqafuar prodhimin e orientuar nga zinxhiri i blerës, ekziston mundësia që kontributi i sektorit në ekonominë kombëtare të rritet në mënyrë domethënëse dhe të përmirësojë jetesën e fermerëve.

SARED mbështet zhvillimin e katër prej zinxhirëve më të rëndësishëm të vlerës në zonat rurale malore:

bagëtitë e imta
frutat dhe arrorët

bimët mjekësore dhe aromatike
turizmi rural

Qasja e zinxhirit të vlerës kombinohet me përmasat territoriale të zhvillimit ekonomik lokal e rajonal.



SARED-i mbështet katë zinxhirë vlere: bagëti të imta, bimë mjekësore dhe aromatike dhe fruta e arrorë dhe turizmin rural

SARED-i po punon duke çuar më tej përvojën e projekteve të mëparshme dhe atyre në vazhdim dhe është në kërkim të sinergjisë me projekte të tjera të GIZ-së, që kanë si objekt të njëjtët zinxhirë vlere. Të tillë janë, Instrumenti i financuar nga BE-ja për Ndihmën e Paraanëtarësimit (IPARD) Like dhe Projekti i Ruajtjes së Agrobiodiversitetit në Zonat Rurale (CABRA). Të tjera projekte për formimin profesional dhe zhvillimin ekonomik ofrojnë mbështetje dhe shërbejnë si plotësues për projektin në fjalë, sidomos kur vjen puna te ndërhyrjet e tyre në nivel kombëtar.

Rezultatet e pritshme

Objekti i përgjithshëm i SARED-it është rritja e të ardhurave për aktorët e zinxhirit të vlerës me të paktën 20% dhe ulja e papunësisë në rajonet e mbuluara nga programi.

Ashtu si në vende të tjera, edhe në Shqipëri, sektori bujqësor mbizotërohet nga burrat, edhe pse kontributi i grave është i barazvlefshëm me ta. SARED-i do t'i kushtojë vëmendje të veçantë ofrimit të mundësive për gratë. Në përputhje me strategjinë e ISARD-it, objekti është që, të paktën 15% e përfituesve të drejtpërdrejta, të jenë gra. Këto objektiva ambicioze do të arrihen përmes katër shtyllave të ndërlidhura mbështetjeje dhe ndërhyrjesh:

- Një paketë grantesh për investime, me shumë deri në 6.5 milionë euro për të ndihmuar në rritjen e aktorëve të katër zinxhirëve të vlerës që mbështeten. Grantet për investim do të jenë në përputhje me kontributet e dhëna nga përfituesit. Përfituesit e mundshëm janë fermerë, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, që janë të angazhuara në zinxhirët e vlerës. Këtu përfshihen përpunuesit, tregtarët, si edhe ofruesit e shërbimeve në kuadrin e turizmit rural. Ka rregulla të posaçme për grante në favor të pjesëmarrjes së fermerëve dhe sipërmarrëseve të rinj dhe grave dhe për të përshpejtuar procesin e ngritjes së rrjeteve dhe/ose shoqatave të biznesit përgjatë zinxhirëve të vlerës. Investimet do t'u japin mundësi aktorëve të zinxhirit të vlerës të rrisin efikasitetin dhe cilësinë e prodhimeve dhe shërbimeve të tyre dhe, minimalisht, të përmbushin standardet kombëtare mjedisore dhe të cilësisë. Në këtë shtyllë, SARED-i do të krijojë, gjithashtu, lidhje me sektorin financiar dhe do të përmirësojë kapacitetet e përfituesve të përfituar financim për investimet e tyre aktuale dhe të ardhshme.

- Mbështetja për diversifikimin e veprimtarive ekonomike në fermës e jashtë fermës, në përputhje me kushtet dhe kërkesat e tregut. Këtu përfshihet nxitja e zhvillimit, konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së zinxhirëve të vlerës, duke integruar prodhuesit parësorë në zinxhirin ushqimor, përmes skemave të cilësisë. Kjo do të ndihmojë për përmirësimin e perceptimit të cilësisë së prodhimit në të gjitha hallkat e zinxhirëve të vlerës, nga fermeri, te konsumatori fundor. Ky rezultat do të arrihet duke futur teknologji prodhimi e përpunimi të përmirësuara e novatore, që do të sjellin prodhime të reja e të përmirësuara. Edhe potenciali i prodhimit organik do të eksplorohej.

Do të inkurajohet vendosja e standardeve dhe certifikimit të sigurisë ushqimore dhe do të ofrohet ndihmë për hallkat përkatëse të zinxhirit të vlerës, ndërsa hartohen dhe zbatohen strategjitë e marketingut. Kjo qasje do të bëjë që gjithnjë e më shumë prodhues t'u afrohen standardeve të BE-së, përfshi krijimin e markës, transparencën dhe gjurmueshmërinë e prodhimeve të tyre.

- Ndërmjetësimi për krijimin e lidhjeve më të ngushta midis aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të vlerës, fuqizimi i fermerëve dhe sipërmarrësve të shkallës së vogël dhe pozitave të negociimit në raport me aktorët më të mëdhenj të zinxhirit të vlerës. Marrëdhëniet e kanalizuar në zinxhirin e vlerës përmes rrjeteve të biznesit, deri te shoqatat formale duhet të shndërrohen në një praktikë të zakonshme në rajonet malore. Kjo praktikë mund të arrihet duke ngritur platforma dialogu dhe nëpërmjet programeve të punës e trajnimit. Projekti mbështet, gjithashtu, ngritjen e shoqatave të posaçme të grave të zonave rurale malore.
- Lehtësimi i dialogut publik-privat, me qëllim që të përmirësohet klima e biznesit lokal për fermerët dhe ndërmarrjet e angazhuara në zinxhirët e vlerës. Plane veprimi të hartuara sipas përparësive për përmirësimin e klimës së biznesit dhe mundësive, përfshi përmirësimin e kuadrit institucional, administrativ dhe ligjor. Kjo mund të shërbejë, po kështu, si mundësi për zhvillimin dhe emërtimin e produkteve me Emërtuesin e Mbrojtur të Origjinës (EMO), Treguesin e Mbrojtur Gjeografik (TMG) dhe Specialitetin Tradicional të Garantuar (TSG).

Botuar nga	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
	Me seli të regjistruar në Bon dhe Eschborn, Gjermani
	GIZ-SARED, Mbështetja gjermano-daneze për Bujqësinë dhe Zhvillimin Ekonomik Rural në Zonat e Pafavorizuara
	Ole Henriksen Kutia postare 2391, Rr. "Skenderbej", Nr 231, Tiranë, Shqipëri T +355 4 22 30 414 / F + 355 4 22 51 792 E Ole.Henriksen@giz.de www.giz.de
Autori (ët)	Ole Henriksen, Berthold Wohlleber
Faqosja	Rudina Hoxha
Data	Tetor 2015

GIZ-ja është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij botimi.

Në bashkëpunim me:	Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZhRAU)	
Për llogari të	Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)	
Departamenti	Evropa Juglindore dhe Evropa Lindore; Kaukazi Jugor	
Adresa postare e zyrate të BMZ-së	BMZ Bonn Dahlmannstraße 4 53113 Bonn, Germany T +49 (0)228 99 535-0 F +49 (0)228 99 535-3500	BMZ Berlin Stresemannstraße 94 10963 Berlin, Germany T +49 (0)30 18 535-0 F +49 (0)30 18 535-2501
	poststelle@bmz.bund.de www.bmz.de	